



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:192313

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05603248

P.nr.124A/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarve A. H. nga F.K.akuzuar për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 të KPRK-së dhe A. S. nga F. K. i akuzuar për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.5067/23 të datë 11.09.2023 në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 05.04.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Esat Rama dhe të akuzuarve A. H. dhe A. S., me datë 05.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 22.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. A.H., i biri i A.... dhe nëna A...., e gjinisë L...., i lindur me në P....., me vendbanim në Rr.” F..... K...., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, student i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës dhe
2. A. S., i biri i B.... dhe nëna, e gjinisë, i lindur me në P....., me vendbanim në Rr. “.....” fshati N..... KK F. K...., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës

JANË FAJTORË

Sepse:

I pandehuri A. H. Me datën 08.07.2023, rreth orës 09:37 në rrugën “D....” në F.... K...., i pandehuri A. H. pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, ashtu që kur zyrtarët policor e kanë ndaluar të pandehurin gjatë kontrollit të pandehurit A. H. i është gjetur substancë narkotike, me peshë neto 0.52 gramë, e cila sipas raportit të ekspertimit të AKF-së përmbanë Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC).

- Me këtë e ka kryer veprën penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge* nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.

I pandehuri A. S. me datën 08.07.2023, rreth orës 09:37 në rrugën “.....” në F... K....., i pandehuri A. S. pa autorizim ka poseduar substancë narkotike, ashtu që kur zyrtarët policor e kanë ndaluar të pandehurin gjatë kontrollit të pandehurit A. S. i është gjetur substancë narkotike, me peshë neto 1.47 gramë, e cila sipas raportit të ekspertimit të AKF-së përmban Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC).

- Me këto veprime, i pandehuri, ka kryer veprën penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*, nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 43, 69, 70, 71, të KPRK-së neneve 358, 359, 360, 361 dhe 364, të KPPRK-së, të pandehurit i:

GJYKON

1. Të akuzuarin A. H.

Me dënim me gjobë në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) Euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme prej 0.52 gramë dhe urdhërohet asgjësimi i saj, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë shumën prej 20 (njëzet) Euro si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

1. Të akuzuarin A. S.

Me dënim me gjobë në shumë prej 200.00 (dyqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë shumën prej 20 (njëzet) Euro si dhe shumën prej 20 (njëzet) Euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme 1.47 gram dhe urdhërohet asgjësimi i saj, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.5067/23 të datë 11.09.2023, ndaj të akuzuarve A. H. për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 dhe A. S. për shkak të dyshimit të bazuar mire se kanë kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penalo juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.04.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit, Eset Rama dhe të akuzuarve A. H. dhe A. S. ku të njëjtit u njoftuan me të drejtat e tyre, me aktakuzën dhe provat kundër tyre.

Seanca ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit ku pas leximit të saj të pandehurit u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të akuzuarve, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare dhe se të pandehurit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si ne aktakuzë. Gjykata konstatoj se të akuzuarit e pranojnë fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, të akuzuarit janë të vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akuzuarve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurve A. H. dhe A. S. qëndrojnë të gjitha elementet e veprave penale për të cilat akuzohen sipas aktakuzës.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të akuzuarit e kanë kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarit, gjykata ka vlerësuar faktin se të njëjtit më parë kishte sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier të përgjegjshëm për veprimet e tyre dhe duke shpreh keqardhje për veprat që kanë kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarve. Rrethana rënduese Gjykata nuk gjeti

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 43 te KPRK-se te akuzuarit i gjykoi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit, me te cilat dënime do te arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se vërejtja shqiptuar te akuzuarve është ne përputhje me shkallen e përgjegjesisë penale te tyre dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te pandehurve ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do te ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 te KPPRK-se.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 te KPPRK-se si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364, 498, 499 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.124A/23 datë 22.04.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.